

CEL Kosova dhe Universiteti i Prishtinës

Diskursi publik dhe gjuha e përdorur ndaj personave LGBTQI+ në zgjedhjet lokale:

Rast studimi: Komuna e Prishtinës dhe Lipjanit



Hulumtuese: Bulza Gashi & Dafina Morina
Mentore: Dr. Rita Selimi

Nëntor, 2025

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

HULUMTUESE: BULZA GASHI & DAFINA MORINA

MENTORE: DR. RITA SELIMI

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Ambasada e Holandës në Kosovë, Ambasada e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Global Fund for Women, dhe është bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbatja e publikimit është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerëve dhe donatorëve.

Abstrakti

Diskursi publik nuk është vetëm formë komunikimi por mekanizëm përmes të cilit përkufizohen vlerat kolektive, përcaktohen prioritetet e zhvillimit dhe formësohen marrëdhëniet ndërmjet individit dhe shtetit. Mënyra se si flitet në hapësirën publike, gjuha që përdoret në media, fjalimet e liderëve politikë dhe mënyra se si trajtohen temat e ndjeshme si të drejtat e njeriut, barazia gjinore, përfshirja e minoriteteve apo respektimi i diversitetit kulturor është tregues i shoqërisë dhe i nivelit të zhvillimit të demokracisë së saj (Habermas, 1996). Kur diskursi publik është gjithëpërfshirës dhe pozitiv, mund të nxisë qytetari aktive, solidaritet social dhe respekt për të drejtat themelore të njeriut. Por kur ky diskurs shënohet nga urrejtja, paragjykimet apo manipulimet ideologjike, shndërrohet në një armë që dëmton bashkëjetesën dhe zhvillimin demokratik (Fairclough, 1992). Të drejtat e njeriut janë të pandashme nga mënyra se si trajtohen në diskursin publik sepse nuk janë vetëm parime ligjore të shkruara në kushtetuta apo dokumente ndërkombëtare por janë edhe çështje që kërkojnë një kulturë të komunikimit të përgjegjshëm.

Diskursi publik në raport me çështjet LGBTQI ka filluar të bëhet pjesë e hapësirave/thirrjeve elektorale, përpjekjet dhe avokimi i vazhdueshëm i komunitetit për të drejta të barabarta civile dhe ligjore ka gjetur mbështetje në disa prej kornizave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por kjo situatë ka krijuar një hapësirë ku personat LGBTQI+ shpesh mund të bëhen edhe target i thirrjeve politike kundërgjinore. Studimi i The Outright International (2025) ka gjetur se në 51 shtete të botës në vitin e kaluar gjatë zgjedhjeve është përdorur retorikë kundër personave LGBTQI+ duke i cilësuar si kërcënim për status-quonë. Diskursi destruktiv ndaj personave LGBTQI+ përveç reflektimit të paragjykimeve të mazhorancës së shoqërisë, i njeiti përdoret si mekanizëm i partive politike për të mobilizuar elektoratin e tyre dhe për të mirëmbajtur ideologjitë e caktuara (Bosia & Weiss, 2013; Ayoub & Stoeckl, 2024).

Studiuesit e kanë përshkruar këtë si "homofobia politike" e që nënkupton përdorimin strategjik të retorikës kundër çështjeve LGBTQI+ nga akterët politikë në mënyrë që të arrihet pushtet, avantazh dhe legjitimitet elektoral (Bosia & Weiss, 2013). Nëse analizohet më në detaje, retorika e tillë përqendrohet në vlerat tradicionale e kulturore (Ayoub, 2016), këto thirrje dhe kampanja kundër personave LGBTQI+ fokusohen në a) bindjet moralizuese (portretizimi i personave LGBTQI+ si diqka e dëmshme), b) mbrojtjen e vlerave familjare, c) bindje kundër-gjinore ose portretizimi si "kërcënim i huaj" dhe d) korniza ligjore/administrative (portretizimi se po kërkojnë të drejta më "shumë" e më "ndryshe" se shumica e shoqërisë) (Graff and Korolczuk, 2022; George, 2021; Magni & Reynolds, 2021). Në përgjithësi, ekziston një numër i vogël i përfaqësimit të personave LGBTQI+ në poste të rëndësishme shtetërore. Prandaj, studiuesit kanë hulumtuar nëse retorika kundër personave LGBTQI+ i mobilizon shoqërinë për të luftuar përfaqësimin/personat LGBTQI+, ndryshojnë bindjet e votuesve apo nëse kjo retorikë thjesht i reflekton bindjet aktuale të personave. Studimet tregojnë se në kontekstet kur liderët politikë argumentojnë se bindjet kundër personave LGBTQI+ në një formë do sjellin 'përfitimi politike', kjo i mobilizon votuesit më konservativ apo religjioz (Haas et al., 2025; AbouChadi et al., 2021). Në anën tjetër, avokimi pro personave LGBTQI+ e rrit pjesëmarrjen e personave dhe përfaqësimit LGBTQI+ për angazhimin politik.

Në Kosovë, organizatat kanë analizuar gjuhën e urrejtjes në media dhe diskursin e politikanëve gjatë zgjedhjeve qendrore të shkurtit 2025 dhe të gjeturat tregojnë se asnjë nga partitë politike nuk ka përmendur çështjet LGBTQI+ në programet e tyre dhe asnjëherë të drejtat e qytetarëve LGBTQI+, por kanë evidentuar se ka pasur parti specifike të cilat kanë përdorur gjuhë të urrejtjes ndaj këtij komuniteti, ku të njëjtave i është shqiptuar dënim (Sekhmet Institute, 2025). Raporti argumenton se partitë politike synojnë që të drejtat e personave LGBTQI+ t'i mbajnë nën petkun e argumentit mbi të drejtat e njeriut por se nuk diskutojnë mbi çështjen në mënyrë të hapur dhe nuk e afirmojnë votuesin LGBTQI+.

Prandaj, organizatat gjatë kohës së fushatave zgjedhore, në selitë e gjithë partive politike vendosin thirrjet "LGBT Voton" si rikujtim për konsiderimin e komunitetit si pjesë e elektoratit dhe si reagim ndaj heshtjes së partive për të përfshirë nevojat/thirrjet e komunitetit si pjesë të planprogrameve të tyre (Dylberizm, 2021). Ndikimi i diskursit negativ në raport me çështjet LGBTQI+ ka pasoja të mëdha në aspektin personal dhe strukturor. Në aspekt personal, diskursi i tillë dhe ekspozimi ndaj mjedisve e gjuhës armiqësore mund të ndikojë në sigurinë, marginalizimin dhe mirëqenien e personave. Kur personat LGBTQI+ portretizohen publikisht si "të huaj", "të rrezikshëm" "imoralë" apo me çfarëdo etiketë negative, kjo ndikon në mirëqenien e tyre psikologjike (Meyer, 2015). Ndërsa, në nivel strukturor, ky diskurs politik kthen mbrapa lëvizjen dhe zhvillimet të cilat kanë ndodhur, poashtu i diskurajon personat LGBTQI+ që të jenë politikisht aktivisht qoftë përmes pjesëmarrjes në politikë, votimit etj (Ayoub, 1983; Flores, Lewis & Miller, 2018). Diskursi i vazhdueshëm kundër personave LGBTQI+ poashtu ka efektin që të krijojë mjedise ku grupet kundër bashkohen dhe forcohen duke e ulur kështu solidaritetin shoqëror.

1.1 ZGJEDHJET LOKALE 2025 NË KOSOVË

Në Kosovë, fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale ka filluar nga 13 shtatori deri më 11 tetor 2025, në 38 komuna. Pjesëmarrja në këto zgjedhje sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ishte vetëm 39.07% duke reflektuar një rënie të dukshme krahasuar me ciklet e mëparshme (Balkanweb, 2025). Ky nivel i ulët pjesëmarrjeje u interpretua nga analistët si shenjë e mosbesimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike dhe partive politike. Zgjedhjet lokale 2025 u zhvilluan në tension mediatik ku rrjetet sociale luajtën rol dominues në formësimin e opinionit publik dhe në shpërndarjen e mesazheve politike. Kandidatët për kryetar komune përdorën platforma si Facebook, Instagram për të komunikuar me votuesit për të promovuar programet e tyre dhe për të ndërtuar narrativën e fushatës. Zgjedhjet lokale 2025 treguan për një proces që megjithëse formal në aspektin demokratik mbart sfida të thella në dimensionin e përfshirjes dhe barazisë. Roli i komunikimit politik në formësimin e perceptimit publik është fundamental dhe mënyra se si kandidatët i qasen temave të ndjeshme si orientimi seksual, identiteti gjinor dhe barazia përbën një tregues të rëndësishëm të zhvillimit demokratik.

1.2 QËLLIMI I STUDIMIT

Duke pasur parasysh se në Kosovë nuk ka pasur ende ndonjë praktikë të partive të cilat publikisht gjatë fushatave zgjedhore kanë avokuar për qytetarët LGBTQI+ (gjatë mandatit ka raste), ky punim ka për qëllim të analizojë diskursin e kandidatëve për kryetarë komunash në komunën e Prishtinës dhe Lipjanit gjatë fushatave zgjedhore. Ideja e studimit është që të kuptohet se si kandidatët për kryetarë komunalë përfshijnë (mos) nevojat dhe çështje të personave LGBTQI+ në programet e tyre politike dhe retorikën që përdorin në shkrimet dhe paraqitjet e tyre.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim është kualitative, me përdorimin e analizës së përmbajtjes si teknikë. Arsyeja e përzgjedhjes së teknikës së analizës së përmbajtjes ka të bëjë me faktin se studimi ynë ka për qëllim të analizojë të dhëna sekondare si dokumente, shkrime dhe fokusohet në analizën e gjuhës, narrativës, përmbajtjes dhe mënyrën se si diskursi i përdorur formon opinion publik, legjitimitet apo stigmatizim të personave. Përveç tjerash, të analizohen programet dhe angazhimi i partive politike në aspekt përmbajtësor lidhur me programet politike për mirëqenie dhe shërbime sociale. Krippendorff (2013) argumenton se teknika e analizës së përmbajtjes përdoret kur synojmë të interpretojmë materiale dhe të analizojmë kuptimin e tyre. Prandaj si e tillë, kjo teknikë lejon hulumtuesin që të identifikojë temat, mesazhet, narrativën dhe analizojë modelet e përsëritshme të komunikimit.

2.1 PROCEDURA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Analiza është në dy komuna, Prishtinë dhe Lipjan, duke u fokusuar në kandidatët për kryetarë komune gjatë zgjedhjeve lokale. Përzgjedhja e Prishtinës dhe Lipjanit si raste për tu studiuar në kontekst të hulumtimit ka të bëjë me paralelen se Prishtina si kryeqytet ka të qendëruar lëvizjen LGBTQI+ dhe shumica e aktivizmit, shërbimeve nga organizatat dhe vizibilitetit fokusohet aty, rrjedhimisht Prishtina paraqitet si një vend që për shkak të prezencës më të madhe të vizibilitetit LGBTQI+ ka më shumë gjasa për manifestim të diskursit në raport me çështjet LGBTQI+. Në anën tjetër, Lipjani është përzgjedhur si kontekst më semi-urban e që është më pak i ekspozuar ndaj diskutimeve dhe aktivizmit LGBTQI+.

Burimet kryesore të të dhënave do të përfshijnë: programet politike të kandidatëve si dhe postimet e tyre në rrjetet sociale (Facebook) gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në media. Periudha e analizës ishte nga fillimi i fushatës zgjedhore (13 shtator), duke u fokusuar në mënyrën se si kandidatët ndërtojnë diskursin e tyre në raport me çështjet e personave LGBTQI, të drejtave të njeriut, barazisë si dhe programet e tyre në raport me mirëqenien qytetare.

Hulumtueset (studentet) kanë analizuar të gjitha postimet e kandidatëve dhe programet e tyre politike.

2.2 PROCEDURA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE

Të gjitha materialet janë lexuar nga hulumtueset dhe nga leximi fillestar janë krijuar disa kode përmes të cilave është analizuar diskursi i përdorur. Pas kodimit, janë ndërtuar kategoritë tematike përmes së cilave janë përmbledhur të gjeturat, këto kategori kanë përfshirë: Tipologjinë e diskursit, përmendjen eksplicite të komunitetit LGBTQ+, përmendje të të drejtave të njeriut, përfshirjes dhe barazisë, strategjitë vizuale në komunikim (foto/video) dhe konkretësinë e premtimeve për politika gjithëpërfshirëse.

2.3 KONSIDERATA ETIKE

Të dhënat e përdorura në këtë studim janë të gjitha publike megjithatë hulumtueset i janë përmbajtur standardeve etike duke shmangur keqinterpretimin e të dhënave, rrjedhimisht secila hulumtuese ka bërë kodimin veçmas, më pastaj të dyja janë krahasuar për t'u siguruar se interpretimi është objektiv. Ky studim nuk ka për qëllim të gjykojë programet dhe postimet e kandidatëve, por vetëm të analizojë diskursin e përdorur.

Rezultatet

Të gjeturat nga analiza e përmbajtjes tregojnë se kandidatët për kryetar të komunave në Prishtinë dhe Lipjan nuk kanë përmendur asnjëherë në mënyrë eksplicite personat LGBTQI+, as në raport me ofrimin e shërbimeve, avancimin e politikave të mbrojtjes sociale, por as në aspekt negativ të diskursit kundër LGBTQI+. Pra, diskursi i tyre në raport me çështjet LGBTQI+ është neutral. Pavarësisht se në programet e tyre ka përmendje ad-hoc të koncepteve të “barazisë, të drejtave të njeriut”, “gjithëpërfshirjes”, programi i gjithësecilit fokusohet më gjerësisht dhe përmbajtësisht në aspektin e zhvillimeve administrative lokale dhe infrastrukturore, pa iu dhënë hapësirë e madhe apo pa programe shumë konkrete për mirëqenien sociale. Postimet e tyre dhe kampanjat vizuale poashtu fokusohen tek takimet partiake me qytetarë, nganjëherë edhe takime specifike me kategori të caktuara të qytetarëve që përfaqësojnë biznese, forume etj por se nuk ka pasur ndonjë postim lidhur me takimet qoftë me qytetarë persona LGBTQI+ apo komunitete të marginalizuara.

Sa i përket kandidatëve për kryetarë të komunës së Prishtinës, shihet se të gjithë kanë prioritete të ndryshme në programet e tyre, por element i përbashkët i të gjithëve është se asnjë nga kandidatët nuk ka trajtuar drejtpërdrejt nevojat dhe shërbimet për personat LGBTQI+.

Kandidatët megjithatë përmendin koncepte më universale si barazia. Kandidati Përparim Rama fokusohet tek zhvillimet urbanistike dhe modernizimi i Prishtinës, duke përmendur objektivat infrastrukturore. Gjatë fushatës së tij, Rama nuk ka përmendur asnjë thirrje për personat LGBTQI+ por si kryetar komune, në postimet paraprake, Rama ka postuar mbi paradën e krenarisë, mbështetjen institucionale, të drejtat e barabarta. Kandidati Hajrullah Çeku, programin e tij politik e ka të ndarë në tri shtylla: “Qytet që funksionon”, “Kryeqytet që zhvillohet” dhe “Prishtinë që garanton barazi”. Shtylla e fundit është referenca e vetme rrethanore që mundet të aludojë mbi gjithëpërfshirjen dhe barazinë por se nuk përmend eksplicit personat LGBTQI+, por ai përmend përfshirjen gjinore të grave. Kandidati Uran Ismaili e ka të fokusuar programin në në siguri publike dhe mirëqenie qytetare. Në shkrimet, paraqitjet e tij, Ismaili përdor një qasje energjike me synimin e mobilizimit të rinisë. Në programin, shkrimet, paraqitjet e tij nuk ka asnjë trajtim trajton drejtpërdrejt çështjet e personave LGBTQI+. Kandidati Bekë Berisha fokusohet më shumë në aspektin e funksionalizimit dhe ndërtimit të barabartë të lagjeve brenda Prishtinës. Në postimet e tij, përdor termin barazi por duket se aludon më shumë rreth barazisë në investime në raport me shpërndarjen gjeografike të qytetit. Kandidatja Besa Shahini fokuson programin e saj në përmisim të shërbimeve publike dhe drejtësi sociale, pavarësisht se në diskursin e saj ka fokus gjithëpërfshirjen dhe reformën, prapë nuk ka ndonjë shkrim/thirrje për çështjet e personave LGBTQI+.

Sa i përket kandidatëve për kryetar komune në Lipjan, kandidatët nuk e kanë konsideruar të nevojshme përfshirjen e temave të diversitetit apo të drejtave të minoriteteve në agjendën e tyre elektorale. Diskursi i kandidatëve ka qenë i përqendruar në qeverisjen lokale, zhvillimin ekonomik, transparencën dhe administratën komunale ndërsa përmendjet herë pas here për barazi janë të përgjithshme pa ndonjë përmbajtje specifike që të tregojë se kujt i referohen këto koncepte. Kandidati Imri Ahmeti ka fokusuar agjendën e tij elektorale në ofrim të shërbimeve komunale, investime infrastrukturore dhe përmirësime administrative, duke përdorur deklaratat të përgjithshme si “shërbime për të gjithë” por pa ndonjë referim specifik të ndonjë nga komunitetet e marginalizuara. Kandidati Shukri Buja ka fokusuar programin e tij në zhvillimin ekonomik-komunal, në transparencë dhe zhvillime infrastrukturore, njejtë pa iu referuar grupeve të marginalizuara apo specifikisht personave LGBTQI+. Kandidati Ilir Qeriqi programin e tij e ka fokusuar në shërbime qytetare dhe zhvillim ekonomik, ku toni i tij është më neutral, në disa vende përmend konceptin e barazisë pa specifike të veçantë. Ndërsa, kandidati Bashkim Budakova fokusin kryesor e ka pasur tek arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe poashtu te aspekti i rinisë, por sa i përket çështjeve të gjithëpërfshirjes nuk ka përmendur asgjë.

Tabela 1: Analizimi i diskursit për secilin kandidat

Krahasim Kandidatësh – Prishtinë 2025

KATEGORIA	PËRPARIM RAMA	HAJRULLA ÇEKU	URAN ISMAILI
Programi zyrtar elektoral 2025	1 dokument	1 dokument	1 dokument
Postimet në rrjetet sociale	492 postime	290 postime	350 postime
Debate dhe intervista	7 paraqitje	5 paraqitje	6 paraqitje
Tipologjia e diskursit	Diskurs simbolik modern, mesazhe urbane, bashkëpunim, tolerancë	Fokus në projekte lokale, infrastrukturë dhe shërbime për qytetarë	Diskurs teknik, administrativ, fokus në shërbime
Përmendje eksplicite të LGBTQ+ / orientim seksual	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje
Përmendje të të drejtave të njeriut / barazi / përfshirje	Përmendje të përgjithshme: barazi, respekt, përfshirje	Përmendje të përgjithshme: shërbime për të gjithë, respekt	Përmendje të përgjithshme: barazi në qasje
Strategjia vizuale (foto/video nga fushata	Pamje urbane, familjare, ngjyra të hapura	Pamje lokale, takime me qytetarë, projekte infrastrukturore	Pamje institucionale, projekte, takime zyrtare
Sa konkret ishin premtimet për politika inkluzive	Pak konkretizime; mungesë masash/ indikatorësh për grupe të margjinalizuara	Pak konkretizime; fokus mbi shërbime universale	Fokus mbi shërbime dhe administrim; pa masa specifike

KATEGORIA	BEKË BERISHA	BESA SHAHINI
Programi zyrtar elektoral 2025	1 dokument	1 dokument
Postimet në rrjetet sociale	150 postime	320 postime
Debate dhe intervista	3 paraqitje	4 paraqitje
Tipologjia e diskursit	Fokus në shërbime dhe zhvillim lokal, pak simbolikë	Diskurs urban dhe edukativ, më shumë simbolikë politike
Përmendje eksplicite të LGBTQ+ / orientim seksual	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje
Përmendje të të drejtave të njeriut / barazi / përfshirje	Përdorimi i formulimeve të përgjithshme	Përmendje të përgjithshme në program dhe komunikim publik
Strategjia vizuale (foto/video nga fushata	Pamje lokale dhe aktivitete komunitare	Pamje edukative, aktivitete me qytetarë dhe komunitete
Sa konkret ishin premtimet për politika inkluzive	Pak konkretizime; fokus në projekte të përgjithshme	Pak konkretizime; premtime simbolike

Krahasim Kandidatësh – Lipjan 2025

KATEGORIA	IMRI AHMETI (LDK)	SHUKRI BUJA (PDK)	ILIR QERIQI (LVV)	BASHKIM BUDAKOVA (AAK)
Programi zyrtar elektoral 2025	1 dokument	1 dokument	1 dokument	1 dokument
Postimet në rrjetet sociale	290 postime	412 postime	277 postime	7 postime
Debate dhe intervista	5 paraqitje	4 paraqitje	5 paraqitje	2 paraqitje
Tipologjia e diskursit	Fokus në shërbime, infrastruktura, administrim.	Infrastruktura, zhvillimi ekonomik-komunal, transparenca	Transparencë, zhvillim ekonomik dhe shërbime qytetare	Fokus primar arsimit, shëndetësia, bujqësia dhe rinia dhe çështjet administrative
Përmendje eksplicite të LGBTQ+ / orientim seksual	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje	Asnjë përmendje
Përmendje të të drejtave të njeriut / barazi / përfshirje	Përdorim i formulimeve të përgjithshme: “shërbime për të gjithë”, “barazi në akses”.	Përmendje të përgjithshme për “përfshirje” dhe “barazi” pa specifikim të grupeve të marginalizuara.	Përmendje të përgjithshme: barazi.	Asnjë përmendje
Strategjia vizuale (foto/ video nga fushata	Përdor pamje institucionale, projekte, takime me qytetarë.	Pamje lokale, takime me qytetarë.	Takime me qytetarë, pamje institucionale.	Pamje lokale dhe aktivitete komunitare
Sa konkret ishin premtimet për politika inkluzive	Asnjë masë e veçantë për komunitete të diskutueshme fokus mbi shërbime universale.	Fokus mbi shërbime universale me fokus administrative/ komunale.	Fokus në zhvillim komunal.	Nuk ka

Diskutimi

Ky studim i cili kishte për qëllim të analizojë diskursin e kandidatëve për kryetarë komunash në komunën e Prishtinës dhe Lipjanit gjatë fushatave zgjedhore dhe të kuptoj se si kandidatët për kryetarë komunalë përfshijnë (mos) nevojat dhe çështje të personave LGBTQI+ në programet e tyre politike dhe retorikën që përdorin në shkrimet dhe paraqitjet e tyre ka konkluduar se diskursi për personat LGBTQI+ në zgjedhjet lokale të 2025 (Prishtinë dhe Lipjan) nuk ishte fare prezent. Kjo mungesë e diskursit qoftë në mbështetje qoftë në diskurs negativ tregon se personat LGBTQI+ nuk shihen fare pjesë e agjendave politikave dhe ky neutralitet pasqyron mungesën e programeve dhe objektivave politike për adresimin e nevojave të personave LGBTQI+. Në dy komunat, me më shumë përmendje në rastin e Prishtinës, kandidatët kanë përdorur koncepte të "barazisë apo "gjithëpërfshirjes" megjithatë nuk i referohen asnjë grupi specifik të marginalizuar. Përveç mungesës së prioritizimit të nevojave të grupeve të marginalizuara, vërehet se partitë politike prioritizojnë aspektet ekonomike, infrastrukturore duke treguar një mungesë në problematizimin, parandalimin, adresimin e problematikave sociale si dhe mungesë në përforcimin e aspektit të mirëqenies sociale. Ky neutralitet mund të interpretohet në disa mënyra, mungesa e diskursit ndaj personave LGBTQI+ mund të jetë si strategji për ruajtjen e elektoratit dhe për të mos hapur tematika që mund të rrezikojnë votat, prapë duke e parë votuesin tradicional e hetero si votues kryesor e të vlefshëm. Apo, mund të jetë si pasojë e mungesës së presionit publik për dhënie të përgjegjësisë në raport me çështjet LGBTQI+ apo se koncepti i barazisë dhe gjithëpërfshirjes trajtohet më shumë si një thirrje abstrakte pa veprime konkrete se si arrihet ajo.

Studimi tregon që personat LGBTQI+ apo grupet e marginalizuara në përgjithësi nuk janë fare të interguara në programet e partive dhe në mënyrë që të arrihet përfshirja e nevojave të qytetarëve LGBTQI+, duhet mobilizim më i madh shoqëror, aktivistë e institucional që nevojat, sfidat, shërbimet e nevojshme për personat LGBTQI+ të mos mbeten të padukshme dhe jo-ekzistente në programet e partive politike.

Referencat

Abou-Chadi, T., Breyer, M., & Gessler, T. (2021). The (re)politicisation of gender in Western Europe. *European Journal of Politics and Gender*, 4(2), 311–314. <https://doi.org/10.1332/251510821X16177312096679>
Available at https://doi.org/10.31219/osf.io/wvnbr_v2

Ayoub, P. M. (2016). *When States Come Out: Europe's Sexual Minorities and the Politics of Visibility*. Cambridge Studies in Contentious Politics. New York, NY: Cambridge University Press.

Ayoub, P., & Stoeckl, K. (2024). The Global Resistance to LGBTIQ Rights. *Journal of Democracy*, 35(1), 59–73. <https://doi.org/10.1353/jod.2024.a915349>

Bosia, M. & Weiss, M. L. (2013). Political Homophobia in Comparative Perspective. In M. L. Weiss & M. J. Bosia (Eds.), *Global Homophobia* (p. 1). University of Illinois Press.

Dylberizm. (2021, 15 shkurt). Dylberat ukujtojnë partive politike se “LGBTIQ VOTON”. Marrë nga <https://www.dylberizm.com/2021/02/15/lgbtiq-voton/>

Fairclough, N. (1992). *Discourse and Social Change*. Cambridge: Polity Press.

Flores, A, and Barclay, S. (2016). “Backlash, Consensus, Legitimacy, or Polarization: The Effect of Same-Sex Marriage Policy on Mass Attitudes.” *Political Research Quarterly* 69, no. 1 43–56.

Graff, A., & Korolczuk, E. (2021). *Anti-Gender Politics in the Populist Moment* (Edition 1). Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781003133520>

Haas, V. et al. (2025) “The Electoral Effects of State-Sponsored Homophobia”, OSF Preprints.

Habermas, J. (1996). *Between Facts and Norms: Contributions to a Discourse Theory of Law and Democracy*. Cambridge: MIT Press.

Krippendorff, K. (2013) *Content Analysis. An Introduction to Its Methodology* (3rd ed). California, CA: Sage Publications.

Magni, G. & Reynolds, A. (2021). Voter Preferences and the Political Underrepresentation of Minority Groups: Lesbian, Gay, and Transgender Candidates in Advanced Democracies. Marrur nga: https://gabrielemagni.com/wp-content/uploads/2020/07/magni_reynolds-jop2020_voterpreferences-lgtcandidates.pdf?utm_source=chatgpt.com

Meyer, I. H. (2015). Resilience in the study of minority stress and health of sexual and gender minorities. *Psychology of Sexual Orientation and Gender Diversity*, 2(3), 209–213. <https://doi.org/10.1037/sgd0000132>

Outright International. (2024). *LGBTIQ People and Elections Around the World in 2024*. Marrur nga: [LGBTIQ People and Elections Around the World in 2024 | Outright International](#)

Prishtinalsnight (2025). *LGBTIQ+ Community in Kosovo Faces Political Exclusion and Hate-Fueled Media Narratives*. PrishtinaInsight. Marrur nga: <https://prishtinainsight.com/lgbtqi-community-in-kosovo-faces-political-exclusion-and-hate-fueled-media-narratives-mag/>



www.cel-ks.org



info@cel-ks.org



+383 49 701 499



www.cel-ks.org



info@cel-ks.org



+383 49 701 499